

Prishtinë 15/03/2007
Kodi i ZRRE-së: D_08_37_2007

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
2. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/10 “Mbi Elektricitetin”;
3. Propozimin e parashtruar Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (“ZRRE”) nga Korporata Energjetike e Kosovës (“KEK”), komentet e parashtruara KEK-ut dhe përgjigjes së KEK-ut, më datë 21 Nëntor 2005 dhe 25 Nëntor 2005 respektivisht;
4. Shqyrtimin e Raportit të Monitorimit për implementimin e politikës së miratuar të furnizimit (ABC)

në seancën e mbajtur më 15 mars 2007 ka vendosur të:

a) Të ndryshojë Vendimin D_08_2005 si vijon:

“Duke filluar nga data 1 maj 2007, KEK-u është i obliguar të konsiderojë si kriter humbjet e përgjithshme në procesin e kategorizimit të konsumatorëve”.

Në kuptimin e këtij Vendimi, KEK-u duhet t’i sigurojë ZRRE-së propozimin për:

- **Përqindjen e normës së arkëtimit për secilën kategori A, B dhe C dhe**
- **Nivelin e humbjeve të përgjithshme për secilën linjë dalëse (feeder)**

Dispozitat tjera të këtij Vendimi D_08_2005 mbesin të pandryshuara.

b) Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së

Ali Hamiti
Kryesues

Merita Kostari
Anëtare

Theranda Beqiri
Anëtare

Naim Bejtullahu
Anëtar

Nysret Avdiu
Anëtar